# Q-MAGAZINE

Mars 2013 EDICIONI Nr.10



*Tema Kryesore:*

## GEJ në Kosovë
## ''Mollë e ndaluar''

*LGBT Librat e Muajit*

*Personat Gej Të Ditës*

*Kolumna*

*Filma*

**SHËNDETËSI - KOMUNITETI dhe shumë të tjera...**

# Lidhjet gay në Kosovë ‘’Mollë e ndaluar’’

Të jesh një i ri, homoseksual dhe të flasësh për lidhjet e tua me një mashkull në Kosovë, ironikisht ngjason me të themi ‘’robërit e mbretit të cilët flasin për dashurinë që kanë ndaj bijës së tij’. Është një krahasim që mund të duket qesharak në fillim, por, të rinjtë si unë që janë pjesë e këtij realiteti e kuptojnë shumë mire se për cfarë bëhet fjalë!

Mbase pikërishtë ky fakt i diqkaje në dukje vështirë të realizueshme, tendencat dhe frustrimi për t’i bërë të mundura, qoftë lidhjet apo edhe thjeshtë takimet me meshkuj vetëm sa vijnë e rriten.



*‘’Mund të shihemi vetëm pas orës dhjetë’’, ‘’ Është mirë t’i reduktojmë shetitjet e panevojshme në rrugët ku mund të biem në sy’’, ‘’Mund të takohemi vetëm në X vende apo rrethana’’, ‘’Kujdes se cfarë mesazhe më dërgon në celular’’, ‘’ Nëse më flet në Facebook, kujdes të mos ketë përmbajtje gay mesazhi që më dërgon’’, etj, janë frazat e zakonshme të cilat vijnë menjëherë pas njoftimit me një mashkull.*

Fatkeqsisht këto ‘’fraza’ , të cilat janë shndërruar edhe në stil të të jetuarit për të meshkujt gej në Kosovë, ndonjëherë dijnë edhe të të lodhin dhe të të demotivojnë në dëshirën për të funksionuar në një lidhje me partnerin e dëshiruar.

Kështu me e pa dashje, edhe në qoftë se je më romantik se në kohën e romantizmit, nga nevoja bëhesh pjesë e takimeve me qëllim të përfundimit në shtrat dhe kalimit të pak qasteve ‘’underground’’ me dikë që mbase do të doje të putheshe mu në mes të qytetit.

Më kujtohet takimi më i bukur i jetës simë, dy vite më pare, takim i cili erdhi pas një bisede në Facebook- profilin tim të rrejshëm, sigurisht! Që në fillim të bisedës më dukej ndryshe dhe fjalë pas fjale, pa u parë fare në kamerë, mbase për shkak të respektit që krijuam gjatë bisedës, vendosëm të takoheshim. ‘’Si të them, unë jam shumë i bukur’’, më tha, i thash ‘’ Të siguroj që jam nëse jo më i bukur, atëherë po aq i bukur sa ti’’, si në shaka. U takuam në vendin e caktuar dhe nuk na u dashtë shumë për të arritur deri tek nevoja për intimitet. Po të mundesha do i transferoja të gjithë banorët e Prishtinës diku vetëm atë natë, në mënyrë që të shijonim gjiithcka vetëm ne të dy. Por rrethanat dhe vendi, mentaliteti apo cfaredoqofte nuk na penguan që ta realizonim dëshirën që ishte e kjartë që në fjalët e para që shkëmbyem gjatë takimit. Ishim të gatshëm të kishim një lidhje të gjatë, por, sigurishtë që komplikimet filluan të trokasin edhe në rastin tonë.

*‘’Mos më përshendet nëse me sheh me X personin, sepse e njeh babin tim dhe ai më kontrollon shumë në shoqëri’’, ‘’ Kujdes me afërsinë që shfaqim kur jemi në fakultet, sepse njerëzve mundë të u biejm në sy’’, ‘’Pse u dash të ma dërgoje atë mesazh në celular me atë tekst?!’’,’’ Nuk mund të dalim për kafe te filan bari, sepse më duket që kamarierat kanë kuptuar cfarë jemi dhe po na shikojnë quditshëm ‘’.*

Ishin këto dhe shumë gjëra tjera, të cilat , të shtyrë nga rrethanat u desht të i themi njëri-tjetrit dhe të cilat filluan të ndikonin në idenë për të pasur një lidhje monogamike.
Ndonjëherë vështirësitë e tilla shërbejnë si nxitje për të luftuar drejtë realizimit të jetës së lirë, në mënyrën se si ne dëshirojmë. Mua personalisht, pikërishtë këto gjëra më nxisin që të këmbëngulë derisa të vijë momenti kur t’ua prezantoj të dashurin tim secilit që e takoj, apo thjeshtë të mos kem nevojë për kujdes se po më sheh X personi apo dicka të tillë.
‘’ Molla e ndaluar’’, gjithmonë e ka fuqinë dhe sharmin më të madh se të asaj të cilës mund ta kafshosh i lirë, e sidomos kur dëshira vie thellë nga brendësia.

# Gay relationships in Kosovo 'The forbidden apple'

Being gay, young and talking about your relationships with men in Kosovo, ironically resembles with, let's say 'the slaves of the king who talk about their love towards his daughter'. This comparison might sound funny in the beginning, but young people as me, who are part of our society, know exactly what I am talking about! It might be the bare fact of the difficulties to achieve this that increases the tendency and the frustration to make possible either the relationships or simply the dates.

*'We can only meet after 10 o'clock', 'It would be good if we reduce our unnecessary walking's along the crowded streets where we can be seen', 'We can only meet on X places or situations', 'Take care with the messages you send me on my phone', 'If you text me on Facebook, be sure that the message has no gayish content', and lots of other phrases which come immediately after you meet a gay man in Kosovo.*



Unfortunately, these phrases, which have become the lifestyle of young gay men in Kosovo, have the tendency to overstrain you and your desire to make these relationships with you partner work out.

Thus, you like it or not, even if you were more romantic than the ones from the Romanticism, you become part of the dates with the intention of ending in bed and having some 'underground' moments, with the person that you most probably, would love to kiss in the middle of the streets.

I remember the best date of my life, a date that was the result of a Facebook chat, from my fake profile, of course! Since the beginning of the conversation, he seemed different to me, and so, after exchanging some words, we decided to meet, even though we hadn't even seen each other on the camera'. 'What can I say? I am very handsome' – he said. 'Well, I can assure you that I might not be more handsome than you, but I am as handsome as that' – I said joking.. We met to that fixed place and it didn't take long before we felt the need for some privacy. If it would have been possible, I would transfer all the inhabitants of Pristina to some other place, so there could be only the two of us, enjoying everything that night. But the circumstances, the mentality and anything else did not stop us from actualizing the wish that had been clear from the very first words that we had exchanged. We were ready for a long relationship, but of course, the complications started knocking on our door.

*'If you meet me with this X person, do not say hi. He knows my dad and he likes controlling my friendships, as well', 'We should take care on how close we are during the lectures, we might catch our colleagues' eye', 'Why did you have to send that message with such a content', 'We cannot visit this X bar, I think the waiters have already understood what we are and are looking strangely at us'.*

It was these and other factors, forced by the circumstances that started affecting the idea of having a monogamy relationship.

It is these difficulties that force us to fight towards the free lives we dream of. It is these factors that make me, personally, fight till the day that I'll be able to introduce my boyfriend to whomever I meet. 'The forbidden apple' is always more powerful and more charming than the one that you can freely bite, especially if the desire for it comes from the bottom of your heart.

# ÇFARË PRINCESHE! ÇFARË PI



Paramendoni një vend apo një grup njerëzish në mesin e të cilëve do ndjeheshit i pranuar vetëm e vetëm për faktin që jeni Lesbike, Gej, Biseksual/e, Queer apo Transgjinor. Një vend ku do mund t'i iknit homofobisë së përditshme dhe heteroseksizmit. Një vend në të cilin do ndjeheshit të sigurtë. Aty ku e dini që njerëzit ju përkrahin për atë që jeni dhe ndajnë përvoja të ngjajshme. Një hapsirë ku do mund të shpreheshit kreativisht dhe të jeni vetja juaj.

Vetëm komuniteti LGBTQ është ky vend apo grup njerëzish për shumicën prej nesh. Edhe pse këto komunitete priren të përzihen në cdo aspekt, duke filluar nga ahengjet deri tek aktivizmi dhe paradat, secila prej tyre është pak më ndryshe. Kjo nuk do të thotë që si minoritete seksuale apo gjinore ne nuk kalojmë mirë apo nuk mbështesim njëri tjetrin, por në fund të fundit, kur vie puna tek gejët e privilegjuar, meshkujt kanë një përvojë tjetër nga individët transgjinor/seksual.

Komuniteti i meshkujve gej zakonisht ka reputacionin e të qenurit vetëm për seks. Dhe përderisa disa aspekte të kësaj janë dhe mund të jënë, komuniteti gej është shumë më shumë se seks dhe ahengje gjatë gjithë kohës. Pasi që shoqëria ka qenë apo është e mbushur me diskriminim dhe homofobi, ne jemi detyruar të krijojmë komunitetet tona të fshehura për shekuj me rradhë. Pasi që kjo vazhdon të ekzistojë edhe sot, komuniteti vazhdon të provoj të shpreh apo materializoi më shumë se sa ajo cfarë ne na mohohet.

Pasi që njerëzit 'dalin publikisht' tek familjet e tyre jo-pranuese, komuniteti gej shumë shpesh bëhet familja e tyre. Sikurse edhe Rupaul tha në njërin nga shfaqejet e tij Rupaul's Drag Race, 'Ne të duam, je shumë i mirëseardhur këtu. E di, ne si meshkuj gej kemi mundësinë të zgjedhim familjet tona. Kemi mundësine të zgjedhim njerëzit përreth nesh. Unë jam familja jote, ne jemi familje këtu.'. Komuniteti është gjithmonë pranë, pavarësisht se për cfarë ke nevojë, mund të jetë mbështetje, dashuri, seks, ushqim, një pije speciale, një shtrat, kritika, një punë, një pale të brendshme të shtrenjëta, një flakareshë apo cfarë do, vetëm thuaje.

Fuqia e komunitetit u shfaq shumë gjatë 10-15 viteve të para të krizës së HIV/AIDS në Amerikë. Meshkujt gej ishin zënë në një murtajë, me mijëra të vdekur cdo vit. Meshkujt gej, lezbiket dhe mbështetës të tjerë u bënë kujdestarët për shumë prej të dashurve të tyre. Meshkujt gej e dinin që si një grup i stigmatizuar, ata duhej të luftonin për veten e tyre, shokët e tyre, dhe familjet që kishin formuar. Duke mësuar cdo gjë që mundën rreth virusit, ata morrën rrugët, zyrat politike dhe kompanitë e substancave mjekësore për të kërkuar diskutim kombëtar dhe edukim rreth cështjes dhe përfundimisht sigurim të barërave, fondeve dhe mbështetjes.

Disa, duke përfshirë edhe veten, do diskutonin e do mendonin se po të mos kishte qenë iniciativa dhe fuqia e tyre, HIV/AIDS do të kishte qenë shumë më dëmtues se sa mbi 30 milion vdekje sot. Bota ndryshoi dramatikisht, jo vetëm për meshkujt gej por për të gjithë. Kjo është një familje e fortë.

Lloji i familjes që jemi na bënë ne të kemi kulturën tonë unike, gjuhën, ikonat tona në mesin të të famshmeve, baret/klubet, muzikën, tv/filmat dhe ndonjeherë edhe lagjet/fshatrat. Edhe pse të fshehur, pothuajse secili komunitet ka të paktën një bar jozyrtar, një vendtakim, apo një 'cruising' vend. Disa mesh-

# RINCESHE! ÇFARË PRINCESHE!

kuj gej dikur pysnin në keni qenë shokë të ‘Dorthy’, që është një referencë për ikonën gej Judy Gerland (roli Dorthy ne Wizard of Oz) për të identifikuar njëri tjetrin. Tjerët veshnin shami me ngjyra të caktuara për të identifikuar vetveten apo atë qfarë kerkojnë.

Për Krishtlindje unë adhuroj të kaloj kohë me djemtë dhe të shikoj shumë nga filmat tonë të preferuar të John Waters, i cili poashtu është gej. Vetëm shikoni një episodë të ”Rupaul’s Drag Race” dhe do të dëgjoni meshkujt gej duke thënë, what’s the T, no shade, fierce, gurrl, werk, dhe shumë gjëra të tjera të panjohura për shumicën. Mund të konsiderohet stereotip fakti që ne (duke përfshirë edhe veten time) adhurojmë divat që na mbështesin (Brittney, Dianna, Rhianna, Madonna, Gaga, etj.) dhe gjithashtu modën, vallëzimin, ahengjet, një të qarë të mirë, ca pije e kështu..

Diversiteti i komunitetit gej vërehet në komunitete më të mëdha përmes nën-ndarjeve të definuara nga mosha, konstrukti i trupit, statusi politik, lokacioni ose intereset (bears, radical fairies, jocks, twinks, hipsters, ect). Sidoqë të jetë, stereotipi që ne jemi një grup njerëzish të mrekullueshëm që dinë si të kalojnë bukur, s’mund të mohohet

Diversiteti i komunitetit gej vërehet në komunitete më të mëdha përmes nën-ndarjeve të definuara nga mosha, konstrukti i trupit, statusi politik, lokacioni ose intereset (bears, radical fairies, jocks, twinks, hipsters, ect). Sidoqë të jetë, stereotipi që ne jemi një grup njerëzish të mrekullueshëm që dinë si të kalojnë bukur, s’mund të mohohet..

Edhe pse komuniteti gej ka shumë anë të mrekullueshme, aty ende ekzsitojnë disa cështje brenda tij. Shumë shpesh imazhi publik i zakonshëm i meshkujve gej si të bardhë, të hollë, në formë, modern, të pasur dhe shumë tjera është më së shumti i sforcuar nga meshkujt tjerë gej. Komuniteti mund të jetë i mbushur me gjykime në bazë të trupit, racës dhe paragjykime tjera. Gazetari i LGBT-së Michael Musto citon: ‘Ndjej që kur dola publikisht për herë të parë mendoja se do futesha në një botë të mosnënshtrimit dhe individualitetit por, në të kundërtën, doli të ishte një botë e kloneve në një farë mënyre. Gjithashtu urreja gjithë atë gjënë e fashizmit të trupit që kaploi gejët për një kohë të gjatë

Meshkujt gej shumë shpesh edhe përjetësojnë seksizmin dhe transfobinë ndaj lezbikeve dhe biseksualeve dhe individëve transgjinor përmes privilegjit të tyre si meshkujt. Edhe fjalët që meshkujt gej përdorin ndaj femrave sikurse ‘Bushtër’ apo ‘Peshk’ mund të lëndojnë ato. Fjala ‘peshk’ si një kompliment, përdoret nga meshkujt gej për t’iu referuar dikujt që duket shumë femërore, por duke pas si prapavijë aromën e një vagine të palarë. Të tjerët përdorin fjalë si Tranny, ose vazhdojnë të përdorin përemra të pasaktë, bëjnë shaka fyese apo edhe injorojnë individët trans të gjithë së bashku..

Kjo i bënë komunitetet gej dhe LGBTQ më pak mikpritëse dhe pranuese ndaj femrave dhe individëve trans. Gjëja e fundit që komuniteti gej dhe LGBTQ duhet të jetë është diskriminuese apo e ndarë në grupe.

Për fat të mirë, komuniteti gej vazhdimisht provon të jëtë sa më pranues, i hapur dhe më i respektuar që është e mundur. Shumë nga ne ndihen rehat të edukojnë dhe të CALL OUT njëri tjetrin, gjë e cila duhet të ndodhë nëse dëshirojmë të vazhdojmë të rritemi dhe të qëndrojmë të fuqishëm, mbështetes, dhe pozitiv.

*Brogan Geurts*

---

*Shih filmin How to Survive a Plague ose We were Here*
*Intervistë me Michael Musto, David Shankbone. Wikinews, 7 Tetor 2007*






# WHAT A DRAG! WHAT A DRAG



Imagine a place or rather a group of people that you could go to and feel a general sense of acceptance based on the soul fact that you are Lesbian, Gay, Bisexual, Queer and/or Trans*. A place to escape the daily homophobia and heterosexism. A place where you can generally feel safe. One where you know people support you for who you are and share common experiences. A space for creative expression and for people to be themselves.

The larger LGBTQ community is just that place and/or group for many of us. And although these communities tend to blend in every aspect from parties to activism to pride events, each letter tends to be a little different. It doesn't mean that as sexual and gender minorities we don't get along or support each other but ultimately when it comes down to it privileged gay cis-men have a different experience than say trans* individuals. As a gay/queer male I want to tell you about the communities I know, specifically the gay male community.

The gay male community tends to be the largest publically, with most LGBTQ friendly bars catering to gay men, events often being largely male, and even stereotypes and popular culture typically aimed at gay men. There aren't any more gay men than lesbians but the privilege that comes with being male in our society allows men to more openly express themselves or challenge the status quo. For instance, it is usually more acceptable for a male to go out every night or live alone than a female.

The gay male community usually has the reputation for only being about sex. And while some aspects of it are or can be, the gay community is much more than just sex and parties all the time. As society is/has been full of discrimination, homophobia, and heteronormiality we have been forced for centuries to form our own underground communities. As that continues today the community continues to attempt to embody more than simply what we are clearly denied.

As people come out to non-accepting families the gay community often becomes their family . As Rupaul recently told one of the emotionally struggling drag queens on her popular reality show Rupaul's Drag Race, "We love you, you are so welcomed here. You know we as gay people get to choose our family. We get to choose the people we're around. I am your family, we are family here". The community is always there no matter what someone needs, may it be support, love, sex, food, a drink special, a bed, constructive criticism, a job, a pair of overpriced underwear, a slap, you name it.

That power of the community was really shown during the initial 10-15 years of the HIV/AIDS crisis in America. Gay men were caught in a type of plague, thousands dying each year. Gay men, lesbians, and some allies became the caretakers for the many they loved. Gay men knew as a stigmatized group they had to fight for themselves, their friends, and families they had formed. Learning everything they could about the virus they took to the streets, political offices, and drug company offices to demand national debate and education to the issue and eventually obtain life saving medications, funding, and support.

Some, me included, would argue that if it had not been for their initiative and power, HIV/AID's would have been/be far more detrimental than its more than 30 million deaths today. The world for not only gay men but all humans was dramatically

# G! WHAT A DRAG!

changed. That is a strong family.

The type of family we are gives us our own unique culture, language, celebrity icons, bars/clubs, music, TV/films, and even sometimes neighborhoods/villages. Being pushed underground almost every community has at least one unofficial bar, meeting spot, or 'cruising' place. Some gay men use to ask each other if they were friends of 'Dorthy' to identify each other, a reference to the gay icon Judy Garland who played Dorthy in the Wizard of Oz. Others wear certain color handkerchiefs to identify himself or what he is looking for.

On Christmas I love getting with the boys and watching too many of our favorite filthy John Waters films, a gay man himself. Just watch one episode of Rupaul's Drag Race and you will hear gay men say things like, what's the T, no shade, fierce, gurrl, werk, and many other things foreign to most. Stereotypes they may be, many of us including myself, love our supporting divas (Brittney, Dianna, Rhianna, Madonna, Gaga, ect.), fashion, drag, dancing, parties, a good cry, a few drinks, ect.

In larger communities the diversity of the gay community is clearly seen through the many sub communities defined by age, body type, status, politics, location, or interest (bears, radical fairies, jocks, twinks, hipsters, ect). However, the stereotype that we are a group of fabulous people who know how to have a fucking good time, well there is no denying that.

And even though the gay community has many amazing aspects to it there are still issues within the community. Often times the common public image of gay men as white, skinny, fit, fashionable, rich and everything else is most rigorously reinforced by other gay men. Communities can be full of body shaming, racism, and judging. Celebrity LGBT columnist Michael Musto is cited as stating, "I feel that when I first came out I thought I would be entering a world of nonconformity and individuality and, au contraire, it turned out to be a world of clones in a certain way. I also hated the whole body fascism thing that took over the gays for a long time.

Gay men also often perpetuate sexism and transphobia towards lesbian and bisexual women and transgender individuals through their privilege as men. Even words gay men use like "bitch or "fish" can be hurtful to women. Fish being a compliment gay men use to say someone looks very female but referring to the odor of an unwashed vagina. Others say words like tranny, continue to use incorrect pronouns, make offensive jokes, or ignore trans* individuals all together.

This makes gay communities and even larger LGBTQ communities less welcoming and accepting of women and Trans* individuals. The last thing the gay community or larger LGBTQ community should be is discriminatory or divided among its own members.

the gay community is always trying to question and be as acceptable, open, and respectful as possible. Many of us feel comfortable educating and calling each other out, which must happen if we want to continue to grow and remain the powerful, supportive, and positive community that we are/can be!

*Brogan Geurts*

---

*See film How to Survive a Plague or We Were Here.*
*Interview with Michael Musto, David Shankbone. Wikinews, 7 October 2007*






# (Fjali, fjali & Fjali)

*Kolumna nga: A. U. / Mars 2013*

Filloj të ndjehem sikurse kam ngecur në një film të Tim Burton. E tërë ajo cfarë jeta ishte është shtrembëruar në "Grayscale" ….Po shkruaj këtë në këtë dhomë të errët me zhurmën e qetësisë në mesnatë. Një përmbytje ambivalenceje më ka ndarë në pjesë pjesë. Prapa kokës sime mund të dëgjojë Siouxsie dhe Banshees duke kënduar: 'Urrej të të tregoj, por duhet të shkojë..' – Edhe unë, nuk di cfarë në djall do të bëj! Pastaj kujtoj një skeAZnë nga Batman Returns, skenë ku Michelle Pheiffer sikurse Catwoman thotë: ' Jeta është lavire dhe tani kështu jam dhe unë.' Filloj të mendoj, cfarë në të vërtetë do të thotë kjo? Unë patjetër që di që jeta është e padrejtë, por për mua si një lavire e lirë e vetëshpallur kjo më duket shumë komplimentare dhe lajkatuese.

Unë jam një njeri i sinqertë dhe i hapur e me një gojë të hapur e cila nuk është e frikësuar të tregojë cfarë ka në mendje. Unë linda si një ujk i vetmuar dhe nuk frikësohem të shqyej një bushtër. Por përsëri, Catwoman elektrizon vetveten me armikun e saj në fund te filmit, kështu që kjo nuk ndihmon edhe aq argumentin tim. Harroni që përmenda dicka të tille. Të fillojmë nga aty ku mbetem, edhe pse vë bast që ju se kujtoni atë pikë, apo jo? Të them të drejtën, as unë! Epo, aq sa unë di dhe aq sa ka rëndësi sot është triku i mbijetesës në kohën e kolegjit. Kjo është cështja dhe obligimi im kryesor tani për tani. Zgjidhja ime e vetme është alkooli dhe tabletat e shumta, leximi i rastësishëm para ndonjë testi dhe shumë muzik e shkrim.

Diku thuhet mbijeto kolegjin me kafe e të cajtura; varja fare! Megjithatë, është mënyra e lehtë e mackave' jashtë problemit. Por ti nuk po jeton nëse nuk sfidon vdekjen disa herë në jetën tënde! Kam Silvia Plath të më mbështesë në këtë, por ups harrova më falni, ajo futi kokën e saj në furrë dhe takoi vdekjen. Sidoqë të jetë, para se e tërë kjo të filloi të bëhet shumë sikurse tek The Bell Jar, të cilën unë po përmend shumë shpesh, do ndërroj temën duke ju treguar cfarë ka ndodhur së fundmi. E di shok i dashur, zgjohesh një ditë në një mëngjes duke ditur që s'dëshiron të bësh ndonjë gjë me ndonjerën prej gjërave në jetën tënde, ndëpren lidhjet sikurse të vendosësh veten në Airplane Mode dhe shkon në restauranin fast food më të afërt për të blerë një qese plot hamburgerë e patatina dhe kalon tërë ditën e natën në shtrat duke shikuar të mrekullueshmit Will & Grace dhe mendon, 'Sa do doja të zgjaste kjo përgjithmonë!'. Por, e di shumë mirë që nuk do ndodhë.

Kështu i kthehem jetës sime, kryej obligimet, kthej e-mailat, dhe dërgoj Z.Sy Ndritur në djall për të mos më shkruar apo thirrurr më. Dashuria, yuck. Ju kujtoni atë pak, apo jo? Djali që më palloi në qytetin e Tiranëve. Kohë të mira, kohë të mira. Dhe kështu përfundon fundjava ime e përtacisë, edhe pse kur je në kolegj, të gjitha ato vite me të vërtetë jane përtace dhe të plogëta. Tani filloi të mendoj që fundjava ishte fillimi i një zingjiri të fundjavëve tjera me rezultate të përgjumura: Moskokëcarje. Tani më as nuk brengosem se ato fundjavë do jenë ditët të cilat me më padurim pres, natyrisht, me një përzierje të zgjidhjes sime të përmendur më parë. Këtë shkrova me një shkelje syri.

Po bisedoja me këtë Znj. Zemër Mira dhe po më tregonte që unë me të vërtetë nuk duhet të jem një person kaq i keq, kjo pasi që unë vetëm dua djemtë që më bëjnë një natë dhe ikin ende pa u zgjuar unë. Për mua, kjo është ajo! Pa lidhje, pa dashuri. Vetëm seks, natyrisht seks të sigurtë. Dhe c'dreq lidhje ka kjo? Ajo më mbajti një ligjëratë të gjatë se si unë në një kohë të jetës sime do kisha nevojë për dikë të kujdesej për mua dhe unë i mbylla gojën duke i thënë 'Unë jam një grua e forte dhe e pavarur e ngatërruar në trupin e një mashkulli' dhe nuk më bëhet vonë për një mashkull të më mbajë.

Citoj Tori Amos në njërën nga performancat e saj të drejtëpërdrejta të 'Professional Widow' ku këndon: 'Më dhuro dashuri, paqe dhe një penis të fortë'. Dhe kjo është zyrtarisht motoja ime. Filloj të mendoj që ka më shumë meshkuj gej 'feministe' sesa që ka vetë femra heteroseksuale. Në njëfarë mënyre, kjo është e pikëllueshme, patetike dhe për të ardhur keq. Kështu shkruan një feministe. Dhe atë, një feministe krenare. Unë parafrazova Megan Mullally sikurse Karen Walker ne një nga episodat e Will&Grace, ku thotë: 'Rregulli i Gejëve!' dhe unë shtoi '..Rregulli i femrave gjithashtu!' sepse ashtu është, pa marre parasysh orientimin e tyre seksual apo dicka tjetër. Unë mund të mos dua të flej me to, por unë patjetër që respektoj, adhuroj, dhe vlerësoj ato shumë më shumë se sa një mashkull heteroseksual do bënte ndonjëhere. Dhe për këtë zonjusha, shtrëngohuni mire dhe luftoni për të drejtat e juaja! Nuk ju duhet një burrë, ju vecse keni një burre brenda jush!

Ngrihuni për veten tuaj dhe besimet e juaja! Dhe me këtë, kontrolloj Tumblr tim sekret të turpit dhe përmbush të gjitha kënaqësitë e mia të fajshme; Oh Zot, turpi! Duke mbyllur të gjitha dritaret dhe duke hapur këtë, peshoj mendimin e ikjes, një derë. Ose një "Gayway", nëse kjo merr ndonjë kuptim. Të jem me cicërimat dhe njerëzit e mi, por vetëm se nuk mund të gjej daljen. Po ruaj dhe po mbyll këtë dokument. Zymtësia e hirtë shpërndahet përreth dhomës dhe hap një dritare të re me Kërkimet Personale, për të cilën besoj e dini c'do thotë..

# Chatter, chatter & chatter

*Column by: A. U. / Mars 2013*

I start to feel like I'm stuck in a Tim Burton movie. All what life is has been distorted into grayscale. I write this in a dark room with the noise of silence in the middle of the night. There has been a flood of ambivalence that has torn me into pieces. In the back of my head I can hear Siouxsie and the Banshees sing: "I hate to stay, but then I hate to leave..." – And I do, I do, I do, I don't know what the hell I'm going to do! Then I remember a scene from Batman Returns where Michelle Pfeiffer as Catwoman says: "Life's a bitch, now so am I." And I start to wonder, what does that really mean? I certainly know that life is unfair, but for me as a self-proclaimed free bitch I find it very complimentary and flattering.

I am an honest, open-minded person with an open mouth that's not afraid to say what is right and what is on my mind. I was born a lone wolf and I'm not afraid to cut a bitch. Then again, Catwoman electrocutes herself with her enemy in the end of the movie so that doesn't really help my argument very much. So, forget I mentioned it before I bum you out reading this. Let's start where we left of, though I bet you don't even remember where we did do you? Well, neither do I. So, as far as I'm concerned and as for what matters to me nowadays is the trick to surviving college. This is my main issue and obligation right now. My own solution is lots of alcohol and pills, the occasional read-through before a test and lots of music and writing.

They say survive college by coffee and crying; fuck that! Though, it is the easy pussy way out. But you're not living, if you don't at least challenge death a few times in your life. I got Sylvia Plath to back me up on this, oops, sorry, I forgot she put her head in the oven and killed herself. Anyways, before this starts to get too much like The Bell Jar and I am mentioning her way too much I change the subject with telling you about what has been going on. You know, my friend, you wake up one morning knowing that you really don't want anything to do with anything in your life, you cut off your connections as if you put yourself on airplane mode and go to your nearest fast-food restaurant and buy a bag full of burgers and fries and you spend all your day and night curled up in bed watching the wonderful Will&Grace and think, "I wish this could last forever!" But, I know it way to well that it won't.

So I partly return to my life, complete obligations, return e-mails, and send Mr. Bright Eyes to hell so he won't call me or text me anymore. Amour, yuck. You kind of do remember him right? The guy that fucked me back in the city of Tyrants. Good times, good times. – So that ends my weekend of laziness, though Awhen you are in college, all those years really are lazy and idle. Back me up people who have graduated!

Now I begin to think that weekend was a start of a chain of weekends to come with the same lethargic result: Carelessness. I don't think now I even care that those weekends are going to be the things I am looking forward to doing the most, of course, with a mix of my solution mentioned above. I wrote that, winking at you.

I was having this conversation with Ms. Honey Heart and she was telling me that I really shouldn't be such a bad person because I just want guys that can basically do me and then leave the next morning before I wake up. To me, that's a great deal. No connections, no "love", no relationship. Just sex, of course, safe sex. And what the hell is wrong with that? She gave me a long lecture about me needing somebody at some point in my life to take care of me and I shut her up by saying that "I'm a strong independent black woman trapped in a gay mans body" and I don't really give a fuck about needing a man to provide for me.

I quote Tori Amos in one of her live performances of 'Professional Widow' where she sings: "Give me peace, love, and a hard cock." And that is officially my motto. I start to think that there are more gay men that are feminists than straight women themselves. This is kind of sad, pathetic and pitiful. This is what a feminist writes like. And a proud one too. I paraphrase Megan Mullally as Karen Walker in one Will&Grace Episode where she says: "Gays rule!" and I add "...And women rule too!" because they do, no matter their sexual orientation or anything else. I might not want to sleep with one, but I certainly respect, admire, and value them more than any straight guy ever will. With that said, ladies, buckle up and fight for yourselves and your rights! You don't need a man, there's already a man in Woman.

Stand up for yourself and what you believe in! – With that said I check my secret shame-based Tumblr and fulfill all my great guilty pleasures; my God, the embarrassment! Closing all windows and opening this one I ponder the thought of escaping; a gateway. Or a gayway, if that makes sense. To be with my peeps, my people, but I just can't find my way out. I save and close this document. The gloom of grey shatters around the room and I open a new window with Private Browsing. I'm guessing you know what that means...

# (Fjali, fjali & Fjali)

*Kolumna nga: A. U. / Prill 2013*

Denise Levertov dikur tha: 'Ne që jemi gjallë duhet të bejmë te qartë dallimin mes kreativitetit dhe vetë-shkatrrimit'. Po i referohej vdekjes së Anne Sexton. Kisha pas qenë i pasigurtë; për gjithcka, në të vërtetë. Një kapitull i mbyllur më nevojitej. Por mezi po gjeja fillimin. Dhe mendova: 'Jam vetëm nëntëmbëdhjetë vjecar dhe jam kaq rremujaxhi'. Eh, kjo është jeta për ju. 'Mendoni që është vetëm një fazë, hm?' Ja, më besoni mua, për një kohë të gjatë edhe unë dëshiroja të ishte vetëm një fazë, gjithashtu! Këto janë gjërat që sillen në kokën time atëherë kur provoj të flas me dikë tjetër pos vetes sime. Trishtueshëm e gëzueshëm, kam kaluar fazën e mohimit. Tani jam vetëm i zemëruar. Mendoj që jam duke kaluar nëpër pesë fazat e vajtimit të Kübler-Ross: mohimi, zemërimi, pazarllëku' (ose sic Jack McFarland do thoshte: lëkura), depresioni dhe pranimi.

Me të vërtetë mundohesha të bëja tregti për një parë cizme të lëkurës kohë më parë, kështu që mund vetëm të jem një individ i zemëruar, i cili do lëkurën. Prej se u ndamë, ky ishte Marsi më i ngadalshëm në jetën time. Është ironike të thuhet Marsi i ngadaltë tani që jemi të fund të tij. Dhe kur shikoj prapa është e tëra mjegullim, sikurse një ëndërr e keqe, një ëndërr në të cilën dëgjon të qeshura të jehojnë, e di që po vrapon dhe zgjohesh me të rrahurrat e zemrës gati jashtë krahërorit tënd. Por të kthehemi, Airplane Mode, kolegji, ikja nga të dashurit, i mbyllur në një kornizë të sigurisë dhe i vendosur në letër. Është me të vërtetë e kënaqëshme; me të vërtetë kënaq nevojat e mia kur shoh fjalët e mia në një letër të bardhë. Tani besoj se ekziston një arsye pse ne kemi nevojë për drunjë: të shkatërroj ndjenjat e mia! Le të hedhim dramaturgjinë në një vrimë; kemi shumë për të treguar. Tani shok i dashur, shpresoj të të mos vie keq të të thëras shok pasi që tani ke përcjellur këtë për disa kohë, është që po ndihem i ngecur, "fucked" dhe pa pikë fati. Dhe kjo është sjellshëm e thënë. Kisha pas qenë duke folur me

Djaloshin tim Verior të shtatë viteve dhe një natë fillova të qaja, të qaja sepse isha lodhur duke pasur një oqean në mes nesh. Në njërën mënyrë apo tjetrën, kisha zgjedhur atë të ishte shpëtimtari im,. Të më shpëtoj nga vetja ime; që do të thotë, nëse aeroplani i tij ateron në kohë. Nëse jo, ai mund të më vizitojë gjashtë këmbë nën tokë. Të mendosh që unë, të emëroj dikë si shpëtimtarin tim, është patetike; unë, ai i cili i mendon meshkujt si kondomë për një përdorim. Kisha zgjedhur këtë mashkull të ri të ishte shpëtimtari im pa asnjë arsye të qartë. E di që do më urrejë pasi të më njoh mua, të vërtetin. Kjo është ajo cfarë unë kam me lidhjet, problem jam gjithmonë unë. Është e trishtueshme kur do gjithcka, por në të vërtete nuk do asgje, e trishtueshme kur do dashurinë por në të vërtete nuk e do. Është e trishtueshme kur do botën, por në të vërtetë do vetëm një vaskë të mbytesh, e trishtueshme të dëshirosh të jetosh e në të njejtën kohë të vdesësh. Në të vërtetë, është e trishtueshme që tani po ndihem si një pacient që flet me psikiatrin e tij duke ditur që është gati të më vendos në tretman shoku. Është vetëm se nuk mund të ndal zhurmën (e nevojës) në kokën time. Joy Division fillon të luajë në të papritur dhe unë mund të dëgjojë Ian Curtis duke kënduar: "A loaded gun won't set you frë, so you say..." Yes, my very own Unknown Pleasures.

Një shishe e zbrazur, një pako tabletash e përbirë komplet, mu brenda këtij trupi të kotë, minuta pasi ndihem sikurse po lundroj, ligjet e fizikës suspendohen dhe unë nuk mund të mbajë peshën time; shtrihem dhe sapo kthejë vetëdijen pak mund të dëgjoj Siouxsie dhe Banshees: "A piece of mind left dying, dizzy, oh so dizzy, below the waves, below their grace, your hair is gorgeous..." Dhe buzëqesh. Është kënga ime, fjalët e mia, ajri im, nata ime dhe momenti im. Kjo kafshë nate që jam unë, kjo kafshë që kutërbon kajsi, djersë deri në dremitje. Jam gjallë; Hap sytë për një ditë të re. Tani, edhe vdekja më refuzon.

Televizori është duke u dridhur, muzika është e heshtur dhe muret e bardha përreth meje janë të mbuluara me hije bajukesh qe vien nga dielli jashtë. Jam i përgjumur; shtrij dorën time, gjethcka është zbrazët, sikurse unë. Por trokëllima në kokën time është ende e njejta. Cfarë mënyre për të jetuar një ditë tjetër. E përfundoj si gjithmonë, me rutinën time. Tani dëgjoj disa tinguj pianoje në kokën time dhe kujtoj që është Tori Amos ' Upside Down' dhe cfarë është më e përmbysur se unë? Ironikisht, ajo po këndon ' Chatter, chatter, chatter…' në këngën e saj dhe unë lëshoj një psherëtimë kënaqësie.

Sido që të jetë, tani jam i lumtur; ha, 1 Prilli, dita e mashtrimeve! C'shaka e krimbur; ngreh veten time jashtë shtratit për të vazhduar me ditën time, dhe mund ta mendosh sa emocionuese është kjo? Ndjenja ime sarkastike duket se nuk është zhdukur dhe ka qëndruar në takt. Zyrtarisht jam një i 'Vdekur që jeton' një lloj mumje por me një zemër që rrah, dhe është e pabesuar se si qetësuesit bëjnë punën e tyre, ata vrasin cdo muskul, cdo venë dhe cdo eshtër në trup, por truri mbetet i paprekur. Është sikurse të ketë një mburojë përmes së cilës vetëm një objekt solid mund të kalojë; dhe jo ndonjë rrumbullak i keq që shkrihet. Apo ndoshta jam vetëm une? Pasi t'i ikësh shtratit, të veshësh dicka të mirë, të futesh në veturë dhe të largohesh, bën pyetjen 'Në cfarë jam shndërruar?' dhe 'Në cfarë do shndërrohem?' dhe 'Si mund të ik nga dicka brenda meje?'. Thjeshtë, nuk mundesh. Ulesh në ulësen tënde, luan Marina & the Diamond's 'Electra Heart" dhe dëgjon : "Lindur me një zemër të thyer që nga fillimi, dhe tani vdes ngadalë."

# Chatter, chatter & chatter

*Column by: A. U. / April 2013*

Denise Levertov once said: "We who are alive must make clear, as she could not, the distinction between creativity and self-destruction." She was referring to the death of Anne Sexton. I had been unsure; about everything, really. A closed chapter was what I needed. But I could barely find the beginning. And I thought to myself: "I'm just nineteen and I'm already a pandemonium." Well, that's life for you. "You think it's just a phase, huh? Well, trust me, for a very long time I wished it was just a phase too." These are things that go through my head when I try to talk to anyone about myself. Sadly, and gladly, I'm over the denial phase.

Now I'm just angry. Start to think of it, I think I'm going through the Kübler-Ross five stages of grief: denial, anger, bargaining (Or as Jack McFarland would say: leather), depression and acceptance. I really bargained for a pair of leather boots sometime ago, so I might just be an angry individual that is into leather. Ever since we left off, it has been one of the slowest Marches of my life. It's ironic to say, slow march towards the end of March. And when I look back, it's all blurry, like a bad dream, one where you hear a laughter echoing, know you're running and wake up with your heart beating out of your chest. But, let's recap, Airplane Mode, College carousel, fleeing from lovers, caged in a picture frame of safeness and being put into paper. It's gratifying; it truly satisfies my needs when I see my words in plain white paper. I guess now there's a reason why we need trees: To burn down my feelings! Now, let's kick the dramatics down a notch; we have so much to cover.

Now friend, hope you don't mind me calling you a friend as you've been following these for sometime now, is that I feel stuck, fucked and shit out of luck. And that's putting it nicely. I had been talking to my Northern Lad of seven years one night and I started crying because I was tired of having an ocean between us. In one way or another, I had chosen him to be my savior. To save me from me; that is, if that plane he's on lands on time.

If not, he can visit me six-feet-under. To think I, appointing somebody to save my life. It's pathetic; I who think that men are like condoms and you only use them once. I had chosen this young man to be my life-saver for no apparent reason. I know he's going to hate me when he gets to know the real me. That's the thing with the relationships I've got, the problem is always me. It's sad when you want everything but really you want nothing, it's sad when you want love but you really don't. It's sad when you want the world but you only just want a tub to drown, it's sad to want to live and then at the same time want to die. It's actually sad that now I feel like a mental patient talking to my psychiatrist and I know you're ready to put me in shock treatments; it's just I can't stop the noise (of need) in my head. Joy Division starts playing in it all of a sudden and I can hear Ian Curtis sing: "A loaded gun won't set you free, so you say..." Yes, my very own Unknown Pleasures.

One empty bottle, one pill package swallowed whole, right inside this trash body, minutes later I feel like floating, laws of physics are suspended and I can't hold my weight; I lay down and as I regain some focus I can hear Siouxsie and the Banshees: "A piece of mind left dying, dizzy, oh so dizzy, below the waves, below their grace, your hair is gorgeous..." And I smile. The song is mine, the words are mine, the air is mine, the night is mine, and the moment is mine. This nocturnal animal that is me, that reeks of apricot, sweat and honey spirals down to slumber. I am alive; I open my eyes to a new day. Now, even death refuses me. The TV is flickering, music is mute, the white walls around me are covered in some teal shadowing from the sun outside. I am lethargic; I stretch my hand out, all is empty just like me. But, the clatter in my skull is still the same. What a way to live another day. I shut it out like always, almost routine. Now I hear some sort of piano in my head and I recognize that it's Tori Amos' 'Upside Down', and what is more inverted and upturned than me? Or should I say downturned? Ironically, she sings 'Chatter, chatter, chatter...' in the song and I let out sigh of pleasing.

Anyways, now I'm happy; ha, April fool's day! What a lousy joke; I drag myself out of bed and go on with my daily schedule and how exciting is that? My sarcastic wit seems to not have vanished and it's stayed in tact. I'm officially a 'Living Dead', kind of like a zombie but with a beating heart, and it's fascinating how tranquilizers work, they kill every muscle, every vein, and every bone in the body but still the brain is left untouched. It's like it has a shield that only a solid object can tear through; and not some lousy circle that melts. Or is it just me? Once you escape your bed, wear something decent and get in the car and get away, you question, 'What have I become?" and "What will I be?" and "How can I flee from something inside of me?" You just can't. You sit in your seat, play Marina & the Diamond's 'Electra Heart" and hear: "Built with a heart broken from the start, and now I die slow."

# GEJ & SHËNDETI

Shumica e meshkujve gej mbajnë shëndet të mirë përgjatë jetës së tyre. Megjithatë, si meshkuj gej ne kemi përvojat dhe rrethanat tona unike, të cilat shpesh ndikojnë në nevojat e shëndetit tonë fizik e mendor dhe në aftësinë tonë për të marre shërbime të mira shëndetësore. Në shëndetësinë publike apo sferën mjekësore, termi MSM ose meshkujt që kanë marredhënje seksuale me meshkuj, shpesh përdoret për t'iu referuar shëndetit të meshkujve gej në sajë të përfshirjes së saj më të gjërë të të gjithë meshkujve që kanë marrëdhënje seksuale me meshkuj më tepër se sa thjeshtë meshkujt që vetë-identifikohen si gej. Sido që të jetë, për mirëkuptim, ne do përdorim termin 'shëndeti i meshkujve gej' për t'iu referuar shëndetit të të gjithë MSM në këtë artikull.

Shëndeti i meshkujve gej fillimisht ishte sjellur përballë vetëdijes dhe shqetësimit të përgjithshëm përmes epidemisë HIV/AIDS. Edhe pse HIV/AIDS është një çështje e vecantë për shqetësim në mesin e meshkujve gej dhe popullatës së përgjithshmë, meshkujt gej kan cështje të vecanta shëndetësore që kapërcejnë HIV dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme (STIs) për shkak të realitetit tonë shoqëror. Ata priren të kenë nivele më të larta të stresit, ankthit, depresionit, tentim vrasjeve, përdorimit të drogës dhe alkoolit dhe sjellje të rrezikshme seksuale në krahasim me bashkëkohësit tonë heteroseksual. Të gjithë këta faktorë ndikojnë jashtëzakonisht shumë në jetërat tona, komunitetit tonë dhe në të dashurit tonë.

Përjashtimi shoqëror, stigma, homophobia dhe diskriminimi janë të gjithë faktorë shoqëror që ndikojnë në shëndetin tonë fizik dhe mendor dhe mund të ndërhyjnë në aftësinë tonë e të mbajturit shëndet të mire dhe të kërkuarit ndihmë. Fshehja e orientimit seksual apo frika e të 'dalurit publikisht' për shkak të sigurisë fizike, pranimit, mirëqenjes në shtëpi, punë ose situata tjera shoqërore na vendosin në nivele të larta të stresit, ankthit dhe depresionit. Realititeti që duhet të jetohen 'dy jetëra' njëkohësisht nuk është i lehtë, vecanërisht për shëndetin mendor të ndonjërit. Edhe pse meshkujt e hapur publikisht priren të kenë shëndet më të mirë mendor, mirëqenja jonë mendore gjithashtu mund të preket nga qëndrimet negative apo refuzimet që ne marrim nga shokët dhe familja. Kur njëri nuk ndihet i pranuar apo pjesë e shoqërisë, depresioni shfaqet.

Edhe pse femrat vuajnë më shumë nga dhuna shtëpiake për shkak të shoqërisë patriakale në të cilën jetojmë, disa hulumtime tregojnë që meshkujt gej vuajnë nga po kjo dhunë në një nivel të njejtë me femrat heteroseksuale, një nivel dallueshëm më i lartë se sa tek meshkujt heteroseksual. Lidhjet dashurore të meshkujve gej ende jane subjekt për pritjet tradicionale shoqërore ndaj meshkujve, dhe gjithashtu edhe stigma seksuale e brendshme që mund të rezultojë në dhunë psikologjike/simbolike/fizike dhe seksuale; të gjitha llojet e dhunës intime mes partnerëve që mund të ndikojnë në shëndetin tonë fizik dhe mendor e vecanërisht në rritjen e depresionit, stresit, ankthit dhe rrezikut së infeksioneve STI ose HIV.

Të gjitha këto rrethana shoqërore shpesh na deinkurajojnë të takojmë një mjek në kohë nevoje për shkak të diskriminimit dhe homofobisë që ne marrim nga ata. Bëhet shumë e vështirë për shumë meshkuj gej të diskutojnë çështjet e tyre shëndetësore me një mjek të pandjeshëm. Kështu, në raste kur meshkujt gej takojne mjek ata nuk shpalosin të gjitha informatat, duke ulur kualitetin e kujdesit që ne marrim. Nevojat tona mjekësore bëhen përfundimisht të pambikqyrura ose gabimisht te diagnostifikuara për shkak të realitetit tonë.

Për t'u përballur me këtë realitet ose për t'i ikur shkurtë, shumë meshkuj gej kthehen nga alkooli ose abuzimi i substancave; edhe brenda komunitetit gej shumë meshkuj përdorin alkoolin dhe abuzojnë me substanca të ndryshme për t'u përballur me turpin rreth seksit. Ky lloj abuzimi i substancave mund të vendosë meshkujt gej në rreziqe të mëdha të përfshirjes në sjellet e rrezikshme seksuale dhe mundësinë e kontratimit të STI ose HIV. Për më tepër, keqpërdorimi i substancave mund të ndikojë në lidhjet e meshkujve gej, në punësimin e tyre dhe stabilitetin financiar. Tjerët mund të kthehen nga vetëvrasja pasi që ndiejnë që nuk mund të përballen me këtë realitet në të cilin detyrohen të jetojnë. Për tjerët, stigma e të qenurit gej rritet aq shumë saqë është shumë e vështirë të pranohet vetja si i tillë dhe kjo mund të coj deri tek vetvrasja. Vetëvrasja prek të gjithë meshkujt gej por më shumë priret të prek meshkujt më të ri gej.

Shoqëria priret të injoroj nevojat e vecanta shëndetësore të komunitetit tonë (duke përfshirë familjen tonë LGBTI) që na bënë ne të kemi pak informata apo shumë deinformata rreth ceshtjes së shëndetit tonë. Kjo mund të jetë një ndër arsyet komplekse pse meshkujt gej historikisht kanë qenë dhe vazhdojnë të infektohen HIV/AIDS në një nivel më të lartë se sa ndonjë grup tjetër. Është e rëndësishme të kujtojmë se asgje nga fakti që ne jemi gej na shfaq ne tek HIV, por më tepër janë sjelljet e vecanta, në të cilat disa meshkuj gej përfshihen dhe kështu ekspozohen më shumë ndaj HIV, HBV, HCV, ose të tjera sikurse STI. Megjithatë, shoqëria mund ta bëjë më të vështirë për meshkujt gej që të qëndrojnë të shëndetshëm ose të kërkojnë shërbime shëndetësore. Ka mënyra të mbrojtjes së vetvetes, përderisa ne si komunitet ende e vazhdojmë luftën tonë për të drejtat tona.

*Brogan Geurts*

## 10 KËSHILLA PËR TË QËNDRUAR I SHËNDETSHËM

*1.Krijo një rrjet të shokëve dhe familjes mbështetës dhe fol me ta!*

*2.Përdor kondomin secilën herë në seks.*

*3.Fol hapur me partnerin tënd rreth seksit, kondomit dhe STI/HIV*

*4.Testohu rregullisht dhe sigurohu që partneri të bëjë të njejën gjë. Jo gjithkush shfaq simptoma. Bëhu vigjilent.*

*5.Qëndro besnik ndaj partnerit tënd.*

*6.Limito konsumin e alkoolit dhe droges nëse vetëm vendos t'i marrësh.*

*7.Njih dhe raporto rastet e dhunës shtepiake (kjo mund të jetë anonime).*

*8.Gjej një mjek gay-friendlly të cilit i beson dhe ndihu rehat për të diskutuar me të. Takoji rregullisht.*

*9.Nëse ke shqetësime anale ose gjenitale (kruarje të pazakonshme, lirim dhimbjeje, djersitje etj) tako një mjek menjëherë.*

*10.Mos harro që je i dashur nga të tjerët.*

# GAY & HEALTH

*The majority of gay men maintain good health throughout their lives. However as gay men we have unique experiences and circumstances that often affect our physical and mental health needs as well as our ability to receive quality health services. In the public health and medical sphere the term MSM or men who have sex with men is often used to refer to the health of gay men due to its broader inclusion of all men who have sex with men rather than simply men who self-identify as particularly 'gay'. However, for a simpler understanding we will use the term 'gay men's health' to refer to all MSM health in this article.*




*The health of gay men was initially brought to the forefront of public awareness and concern through the HIV/AIDS epidemic. Although HIV/AIDS is a particular issue of concern to this day among gay men and the general population, gay men have specific health concerns that span beyond HIV and other sexually transmitted infections (STIs) due to our social reality. Gay men tend to have higher rates of stress, anxiety, depression, suicide attempts, use of drugs and alcohol, and risky sex behaviors than their heterosexual counterparts. All of these things vastly impact our lives and community as well as our loved ones.*

*Social exclusion, stigma, homophobia, and discrimination are all social determinants of our physical and mental health that can interfere with our ability to maintain good health and seek services. Hiding ones sexual orientation and/or the fear of being outed because of ones physical safety, acceptance, or well-being in the home, work place, or social setting puts us at increased levels of stress, anxiety, and depression. The reality of having to live 'two lives' is not easy, especially on ones mental health. Although out men tend to have better health, our mental well being can also be impacted by the negative attitudes or rejection we receive from our peers and family. When one does not feel accepted or as an important part of society depression sets in.*

*And although women unfortunately suffer higher rates of domestic violence due to the highly patriarchal society we live in, some American studies suggest that gay men suffer from domestic violence at a rate comparable to heterosexual women, a rate significantly higher than heterosexual males . Gay male relationships are still subject to traditional societal power expectations of males as well as internalized sexual stigma that can result in psychological/symbolic battering, physical battery, and sexual battery; all forms of intimate partner violence that can further affect our mental and physical health, especially increasing depression, stress, anxiety, and the risk of STI or HIV infections.*

*All of these social circumstances often discourage us from seeing a doctor in times of need due to overt discrimination and homophobia we receive from doctors. It becomes difficult for many gay men to be able to discuss their health issues with an insensitive doctor. Thus in cases where gay men do see a doctor we may not disclose all relevant information, further decreasing the quality of care we receive. Our medical needs become ultimately unattended to or improperly addressed due to these realities.*

*To cope or briefly escape these realities many gay men often turn to alcohol and substance abuse; even in the gay community many men use alcohol and substance abuse to cope and/or out of shame around sex. This type of substance abuse can put gay men at increased risk of engaging in risky sexual behaviors and the possibility of contracting an STI or HIV. Additionally substance abuse can affect gay men's relationships, employment, and financial stability. Others may turn to suicide as they feel they can no longer cope with the reality in which they are forced to live. For others the stigma of being gay becomes so high it is difficult to accept oneself and they may turn taking their own life. Suicide affects all gay men but it tends to more often affect younger gay men.*

*Society tends to ignore the specific health needs of our community (including our LBTQI family) that leaves many of us with little education or miseducation of our specific health issues. This can be one the complex reasons why gay men have historically and continue to become infected with HIV/AIDS at a rate substantially higher than any other population. It is important to remember that nothing about being a gay man predisposes us to HIV, but it is rather particular behaviors that some gay men engage in that can put them at higher risk for contracting HIV, HBV, HCV, or other STI's, such as unprotected sex or untreated infections. Although, society may make it more difficult for gay men to stay healthy or seek services there are ways to protect yourself while we as a community continue to fight for our rights.*

*Brogan Geurts*

## 10 TIPS FOR STAYING HEALTHY

*1.Establish a network of supportive friends and family and talk to them!*

*2.Use a condom EVERY time you have sex!*

*3.Speak openly with you partner about sex, HIV/STI's and condoms.*

*4.Get tested regularly and ensure your partner does as well. Not everyone shows symptoms. Remain vigilant.*

*5.Be faithful to your partner.*

*6.Limit your alcohol and drug intake if you decide to use them.*

*7.Recognize and report domestic violence issues. (This can be anonymous)*

*8.Find a gay friendly doctor you trust and feel comfortable discussing issues with. See them regularly.*

*9.If you are experiencing any genital or anal discomfort (unusual itching, pain discharge, swelling, ect.) see a doctor immediately.*

*10.Know that you are loved*

# Personat Gej  të Ditës



## Jim Parson

Jim Parson u lind më 24 Mars, 1973 dhe është një ndër personazhet më të famshme në shfaqjen televizive The Big Bang Theory, një shfaqje ku ai luan rolin e më të mencurit. Ai foli për orientimin e tij seksual gjatë një Interviste, ku publikisht pranoi që është gej dhe është në lidhje dhjetë vjecare me një mashkull tjetër.(New York Times)

A National Enquirer Story shkruan shumë hapur për lidhjen e Parson me partnerin e tij, Todd Spiewak, mirëpo ai nuk ka folur për partnerin apo orientimin e tij seksual ende.

## Jim Parson

Jim parson was born in March 24, 1973 and is one of the most popular characters in tv-serie The Big Bang Theory where he plays supreme geek Sheldon Cooper. He came out during an Interview were Jim Parson publicly acknowledged that he is gay and in a 10-year relationship.

(New York Times) A National Enquirer Story from 2010 openly discusses Parson's relationship to his partner, Todd Spiewak, but Parsons hasn't talked about his partner or his orientation in the media.

# Gays Of The Day

## Adam Lambert

Adam Mitchel Lambert (born January 29, 1982) is an American singer, songwriter and stage actor born in Indianapolis but raised in San Diego. He began perfor ming in amateur theatrical productions in childhood, a path he pursued into adulthood, appearing in profe ssional productions in the U.S. and abroad. Lambert became prominent after appearing on the eighth season of American Idol.

Lambert, himself openly gay, has contributed to the advancement of social acceptance towards LGBTQ people. He was presented the “Equality Idol Award” by Sam Sparro at the Equality California Los Angeles annual Equality Awards in August 2011 for being an exemplary role model for the LGBT community. Lambert is currently in a relationship with Finnish entertainment reporter and reality TV personality Sauli Koskinen.



## Adam Lambert

Adam Mitchel Lambert ( i lindur më 29 Janar, 1982) është një këngëtar Amerikan, kompozitor dhe aktor, i lindur në Indianapolis por i rritur në San Diego. Ai filloi të performonte në prodhimet teatrale amatore, një rrugë të cilën e ndjeku në moshë të rritur, duke u paraqitur në prodhime profesionale ne SHBA dhe përreth. Lambert u bë i njohur pas paraqitjes së tij në sezonin e tetë të American Idol.

Lambert, një gej i hapur, ka kontribuar në rritjen e pranimit të komunitetit LGBTQ nga shoqëria e gjërë. Ai morri cmimin ‘Equality Idol Award’ nga Sam Sparro tek Equality California Los Angeles në 2011, duke qenë model për komunitetin LGBTQ. Lambert aktualisht është në një lidhje me gazetarin finlandez dhe personalitetin e një reality show Sauli Koskinen.

# LGBT Librat e Muajit




## Besimi dhe Besnikëria

*Nga Tere Michaels*

Detektivi i New York-ut Evan Cerelli ka humbur gruan e tij, personin e vetëm që ka dashur dhe me të cilën ka fjetur ndonjëherë. Ai mundohet të vazhdojë me jetën e tij dhe të ndërtojë një jetë të mirë për fëmijët e tij. Detektivi i Mëparshëm i Vrasjeve Matt Haight është një burrë shumë i dhënë pas femrave dhe pas seksit mirëpo jo pas përkushtimit. Ai është i depresionuar, duke kaluar në kriza të moshës', dhe i pasigurtë për atë se në cfarë drejtimi po shkon jeta e tij.

Pasi që ndajne pak kohë së bashku duke pirë, këta të dy gjejnë shoqëri mes veti. Kur kjo shoqëri kthehet në dashuri, ajo prek në thelb dy burrat heteroseksual dhe rrokullis jetërat e tyre. A mundet kjo dashuri e madhe të kalojë pengesat pranë tyre, sikurse familja, fëmijët dhe kolegët e tyre, të cilët nuk janë as gay-friendly?




## Djali takon djalin

*Nga David Levithan*

Ky është tregimi i Paul, një student i shkollës së mesme, si asnjë tjetër. Nxitësit e tivozëve ngasin motocikleta Harleys, mbretëresha dikur ishte një djalë i quajtur Daryl (tani ajo preferon të quhet Darlena e Pafund dhe gjithashtu është edhe ylli qendërmbrojtës i ekipit), dhe bashkimi gej-heteroseksual ishte formuar për të ndihmuar fëmijët të mësojnë vallzimin.

Kur Paul takon Noah, ai mendon që ka gjetur njeriun e zemrës. Deri në momentin kur shkatrron cdo gjë. Bastvënësi i shkollës thotë që shancat qe Paul të kthejë Noah prapë janë 12 me 1, mirëpo Paul nuk do dorëzohet pa luftuar fuquishëm për dashurinë e tij. Shoku i tij i ngushtë po largohet, shoku tjetër Tony mundohet të gjejë gjuhë të përbashkët me prindërit e tij shumë fetar dhe ish i dashuri i tij Kyle mund të mos largohet së shpejti, mirëpo nganjëherë cdo gjë duhet të shembet në mënyrë që të vie në vendin e vet si duhet. Kjo është një komedi-romancë me një fund të lumtur rreth gjetjes së dashurisë, humbjes së saj dhe të bësh cdo gjë për të kthyer atë në një botë të cmendur e të mrekullueshme.

# LGBTQ Books of the Months

## Faith & Fidelity

*By Tere Michaels*




New York City Detective Evan Cerelli has lost his wife, the only person he ever loved and slept with. He's trying to get on with his life, build a life for his children. Former Homicide Detective Matt Haight is a ladies' man, all sex/no commitment. He's depressed, having a midlife crisis, and not sure where his life is headed.

The two find friendship in the bottom of a shared bottle. When the friendship turns to love, it shakes two straight men to the core and flips their lives inside out. Kids, families, careers that are not gay-friendly -- can all the love in the world overcome the obstacles to faith and fidelity?

## Boy Meets Boy

*By David Levithan*




This is the story of Paul, a sophomore at a high school like no other: The cheerleaders ride Harleys, the homecoming queen used to be a guy named Daryl (she now prefers Infinite Darlene and is also the star quarterback), and the gay-straight alliance was formed to help the straight kids learn how to dance.

When Paul meets Noah, he thinks he's found the one his heart is made for. Until he blows it. The school bookie says the odds are 12-to-1 against him getting Noah back, but Paul's not giving up without playing his love really loud. His best friend Joni might be drifting away, his other best friend Tony might be dealing with ultra-religious parents, and his ex-boyfriend Kyle might not be going away anytime soon, but sometimes everything needs to fall apart before it can really fit together right. This is a happy-meaningful romantic comedy about finding love, losing love, and doing what it takes to get love back in a crazy-wonderful world.

# FUNDJAVA

***Një paraqitje jashtëzakonisht bindëse e jetës bashkohore gej Filmi 'Weekend' ka dicka urgjente për të thënë rreth dritareve të mundësive në jetërat tona..***




Një ngjarje 'djali-takon-djalin' e cila zgjerohet brenda një vikendi të vetëm. Eshtë një film që paraqet një realizëm të kohës së sotme. Aty ka pikëllim dhe romancë dhe një sens që pervoja seksuale nuk është vetëm emocionuese, por një aventurë drejtë zbulimit të vetes. Ky film ka dicka urgjente për të thënë për audiencën gej dhe heteroseksuale rreth mundësive të ndryshme në jetërat tona.

Russell është një mashkull gej në të 20-tat e tij, i cili duket mjaft i lumtur. Së pari e shohim në një aheng të mërzitshëm, nga i cili largohet dhe përfundon në një gej bar. Aty takon Glen, i cili punon në një galeri lokale të arteve. Ata shkojnë në shtëpi së bashku duke menduar që do jetë një përplasje e shpejtë dhe e këndshme. Por në mëngjes ata mendohen në do mund të kishin një të ardhme së bashku. Por së pari ata duhet të marrin disa vendime për sa i përket monogamisë dhe asaj se cfarë dojnë ata nga jeta pikë së pari, dhe zbulojnë që ata kanë shumë më pak kohë se sa që kanë menduar.

Russell është i butë,i matur dhe i kthyeshëm; Glen është i paturpshëm, me pervojë dhe pak konfrontues për nevojën e tij të mbrojë identitetin e tij gej. Në këto role, këta të dy japin performanca jashtëzakonisht relaksuese dhe bindëse.

Qëllimi i filmit është të përqendroj vëmendjen tonë tek kjo temë shumë sensacionale: mënyra se si Glen dhe Russell do të gjejnë zgjidhje për problemet e tyre dhe të gjejnë dashurinë. Eshtë një film i butë, njerëzor me një gjuhë të lehtë kinematografike; një film që nuk kërkon të përpiqeni shumë.







# WEEKEND

***A tremendously convincing account of contemporary gay life***
***Something urgent to say about the windows of opportunity in our lives … Weekend***




A boy-meets-boy love story extending over a single weekend, and filmed with a kind of real-time realism. There is sadness here, as well as romance, and a sense that sexual experience is not merely exciting for its own sake, but an adventure in defining one's sense of self. Weekend has something urgent to say to both gay and straight audiences about the windows of opportunity in our lives.

Russell is a gay guy in his 20s who seems happy enough. We see him first at a boring party, out of which he leaves and stops off at a gay bar, and meets Glen, who works at the local art gallery. They go home together for what both assume will be a fleeting, pleasurable fling. But in the morning, their conversation continues, and they wonder if they might have a future together. But first, they have to make some decisions on the subject of monogamy and what they want from life in the first place, and they discover they have far less time to make these decisions than they thought.

Russell is gentle, thoughtful, introverted; Glen is bold, worldly and a little confrontational in his need to assert his gay identity.

This movie's concern is always to refocus our attention on the sensational subject: how Glen and Russell are going to work out their problems and find love. It is a tender, humane film, with an easy, unforced cinematic language: a film that doesn't need to try too hard.









EMBASSY OF FINLAND
PRISTINA

FORMIN.FINLAND.FI

Mbështetur nga Ambasada Finlandeze, Prishtinë
Supported by Finnish Embassy Pristina

Publikuar nga / Published by
**Qendra për Emancipim Shoqëror**
**email**: qesh.kosovo@gmail.com
info@qeshkosova.org
**web**: www.qeshkosova.org
**facebook**: www.facebook.com/Qesh